



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Organizatën "QATAR CHARITY" Nr.15-400/01-15243 të datës 31.03.2026, Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit të lidhur në mes të Organizatës "QATAR CHARITY" dhe Komunës së Lipjanit nr.01-016/01-37429 të datës 22.07.2025, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

1.Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve më vlerë prej **34.650.00 €** (tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë euro), konform Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit të lidhur në mes të Organizatës "QATAR CHARITY" dhe Komunës së Lipjanit nr.01-016/01-37429 të datës 22.07.2025, dhe dispozitave të përcaktuara në Raportin specifikues të nënshkruar gjithashtu nga të njëjtat palë me datë 18.12.2025 për realizimin e projekteve për siguri ushqimore, konkretisht serra bujqësore dhe motokultivatorë me frezë kose, motokultivatorë me frezë kose dhe rimorkio që synojnë fuqizimin ekonomik të familjeve në nevojë , mbështetjen e sektorit bujqësor në territorin e Komunës së Lipjanit përmes ndarjes së granteve ku 80% nga vlera e projektit do të bashkëfinancohet nga Organizata "QATAR CHARITY" ndërsa 20% do të bashkëfinancohet nga Komuna e Lipjanit.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhirollogarinë bankare të Organizatës "Qatar Charity" Nr. 1701001600054596 në NLB Banka.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 400/01-23088
Lipjan, më 21.05.2026

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Organizatën "Qatar Charity" për projektin e hapjes së puseve për ujë të pijes për familjet me kushte të rënda ekonomike Nr.15-400/01-15242 të datës 31.03.2026, Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes të Organizatës "QATAR CHARITY" dhe Komunës së Lipjanit nr.01-352/07-66975 të datës 06.12.2023 dhe Aneks Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur me hapjen e puseve për ujë të pijes Nr.01-016/01-37435 të datës 22.07.2025, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

1.Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve më vlerë prej **29.489.40 €** (njëzet e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë euro e katërdhjet cent), konform Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes të Organizatës "QATAR CHARITY" dhe Komunës së Lipjanit nr.01-352/07-66975 të datës 06.12.2023 dhe Aneks Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur me hapjen e puseve për ujë të pijes Nr.01-016/01-37435 të datës 22.07.2025, bazuar edhe në Raportin mbi ecurinë e hapjes së bunareve në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit Nr.12-320/01-36653 të datës 18.07.2025, për realizimin e projektit për hapjen e puseve për ujë të pijes në vende të ndryshme publike për familjet me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit ku 90% nga vlera e përgjithshme e projektit do të bashkëfinancohet nga Organizata "QATAR CHARITY" ndërsa 10 % do të bashkëfinancohet nga Komuna e Lipjanit.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhirollogarinë bankare të Organizatës "Qatar Charity" Nr. 1701001600054596 në NLB Banka.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 400/01-23090
Lipjan, më 21.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit 01-510-24936 të datës 19.05.2025 të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Z. Imri Ahmeti dhe Projektit të Kujdesit Shëndetësor të qasshëm dhe cilësor (AQH) përfaqësuar nga z. Nicu Fota , Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej 3,000,00 € (tre mijë euro), për të vepruar konform dispozitave të Memorandunit të Mirëkuptimit 01-510-24936 të datës 19.05.2025 të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Z. Imri Ahmeti dhe Projektit të Kujdesit Shëndetësor të qasshëm dhe cilësor (AQH) përfaqësuar nga z. Nicu Fota, konform Faturës nr.556 të datës 29.09.2025.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, kategoria ekonomike – investime kapitale, fondi për bashkëfinancim me donator në xhirollogarinë bankare nr. 1125003727000165 në ProCredit Bank në emër të operatorit ekonomik Konti SH.P.K .

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 370/01-17089
Lipjan, më 04.05.2026

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

VENDIM
PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIFIKIMIT TË
PROJEKT BUXHETIT 2027-2029

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim themelohet grupi punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2027-2029, në përbërje si vijon:

1. Latif Ramadani, Drejtor në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, Kryesues
2. Visar Kozhani, Zyrtar në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtar,
3. Alban Bytyqi, Zyrtar financiar në QKMF, anëtar,
4. Behar Aliu, Zyrtar në Drejtoratin për Administratë, anëtar dhe
5. Ferdian Shala, Zyrtar në Zyren e Kryetarit të Komunës, anëtar.

Neni 2
Detyrat e Grupit Punues

Grupi punues ka për detyrë hartimin e projekt planifikimit të buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2027-2029 si dhe organizimin e degjimeve buxhetore në Komunën e Lipjanit. Grupi punues bëne vlerësimin e kërkesave të pranura nga qytetarët dhe vendos cilat kërkesa pranohen dhe cilat refuzohen. Grupi punues duhet të hartojë planin e punës dhe të caktoj orarin e mbajtjes së degjimeve buxhetore duke mbajtur procesverbal dhe duke hartuar raport të punës së kryer të gjitha detyrat e hartimit të planifikimit të buxhetit për vitin 2027-2029 dhe organizimin e degjimeve buxhetore do të bëjë konform dispozitave të parapara ligjore që janë në fuqi. Po ashtu në fund të hartojë raportin nga degjimet buxhetore për ta dërguar në Kuvendin e Komunës.

Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e degjimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

Neni 3
Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-22345
Lipjan, më 18.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR
SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **8,680.00€**, (tetëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/04-20294 e datës 04.05.2026, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 31 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin prill të vitit 2026 me nga 280 euro për secilin rast $31 \times 280 = 8,680.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/04-20294
Lipjan, më 05.05.2026

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF -NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike "Mërgata Fest dhe Sports 2026" Nr.05-453/01-18462 të datës 22.04.2026, në përbërje si vijon:

1. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Saranda Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Viola Hetemi nga OJQ-të anëtare
5. Albulena Isufi, në cilësinë e ekspertës të jashtëme, anëtare
6. Fadil Krasniqi ,Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare rezervë

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike 0,,Mërgata Fest dhe Sports 2026" Nr.05-453/01-18462 të datës 22.04.2025 ,të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR -04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-23473
Lipjan, më 25.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF - Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në kërkesën e DKA –së Nr.1-020/04-21206 të datës 08.05.2026, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Formohet komisioni për përcaktimin e çmimit fillestar për shitjen e prodhimeve bimore të grurit në përbërje si vijon:

1. Liridon Duhlaku, Drejtorati për Arsim, Kryesues,
2. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar dhe
3. Arben Bahtiri, Drejtorati për Arsim, anëtar

Neni 2

Detyrat e Komisionit

1. Detyrë e Komisionit është që të përcaktojë çmimin fillestar për shitjen e grurit në parcelat në pronësi të shkollës "Adem Gllavica" në Lipjan, duke u bazuar në kërkesën e DKA-së Nr.1-020/04-21206 të datës 08.05.2026.
2. Komisioni detyrën e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi do ta kryejë më së largu brenda afatit 8 ditor nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.020/01-21206

Lipjan, më 12.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF -NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –që kanë aplikuar sipas thirrjes publike „1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve dhe 12 Qershorit - Ditës së Çlirimit të datës 08.04.2026, në përbërje si vijon:

1. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Trimor Shamolli, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Saranda Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Erjona Kadriolli në cilësinë e ekspertes të jashtëme, anëtare
5. Vizioni Rinor i Shalës, nga OJQ, anëtare
6. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare rezervë

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike„1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve dhe 12 Qershorit - Ditës së Çlirimit të datës 08.04.2026, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr 020/04-21777
Lipjan, më 13.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-18568 e datës 22.04.2026, duke u bazuar në kërkesën e Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari të datës 06.05.2026, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E
KËRKESAVE TË FERMERËVE

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve konform shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-18568 e datës 22.04.2026 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari për implementimin e projektit: subvencionimi i qumështit për litër, (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesues
2. Rrahim Krasniqi, Drejtorati për Administratë, anëtar
3. Shefki Sadiku, Drejtorati për Administratë, anëtar

Neni 2
Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave/aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për fermerë prodhues të qumështit përkatësisht për implementimin e projektit : subvencionimi i qumështit për litër, të cilët kan aplikuar sipas shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-18568 e datës 22.04.2026 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, brenda afatit prej 30 ditë pune pas pranimit të këtij Vendimi në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-11658 e datës 14.03.2025.

- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.
- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave publikon listën preliminare të përfituesve ku palët e pakënaqura kanë drejtë ankese në Komisionin e ankesave brenda afatit 15 ditor nga dita e publikimit të listës.
- Pas përfundimit të procedurave të ankesave, Komisioni vlerësues shpallë listën finale nëse ka ndryshime nga ajo preliminare varësisht nga Vendimi i Komisionit të ankesave.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-21341

Lipjan, 08.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 paragrafi 4 dhe 5 i Rregullores MF-Nr.02/2013 për Menagjimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, nenit 72A të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar) si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT AD HOC PËR PRANIMIN E PASURISË
JOFINANCIARE –FURNIZIMEVE, SHËRBIMEVE DHE PUNËVE

Neni 1

Përbërja e komisionit

Për pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve, formoj Komisionin ad.hoc për projektin e mekanizmit bujqësorë të llojit Frezë dhe Spërkatëse sipas Aneks Kontratës me numer 613-26-1105-1-2-5/C1176 të datës 02.04.2026, në përbërje:

1. Afrim Sadiku, Kryesues,
2. Shefqet Amerllahu, anëtar,
3. Shefki Sadiku, anëtar.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me dispozitat e Rregullores MF-Nr.02/2013 Menagjimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, nenit 72A të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar) bën pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve, për projektin e mekanizmit bujqësorë të llojit Frezë dhe Spërkatëse sipas Aneks- kontratës me numer 613-26-1105-1-2-5/C1176 të datës 02.04.2026 dhe gjatë pranimi ka për detyrë si vijon:

1. Te verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në perputhshmëri me kontratën për urdhërblërjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në perputhje me Aneks-kontratën dhe urdhërblërjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimi të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimi të pasurisë jofinanciare shënon edhe arsyetimin e mospranimi.

Neni 3

Hyrja ne fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

Nr.01-020/04-67592/2
Lipjan, më 10.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN, ARKIVIMIN DHE ASGJËSIMIN E LËNDËVE NË ARKIVIN KOMUNAL

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim formohet Komisioni për vlerësimin, arkivimin dhe asgjësimin e lëndëve në arkivin komunal, në përbërje si vijon:

1. Burim Gashi, Kryesues
2. Burbuqe Ahmeti Morina, anëtare
3. Ramadan Nuredini, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrë e Komisionit është që në pajtim të dispozitave ligjore në fuqi të bëjë vlerësimin, arkivimin dhe asgjësimin e lëndëve të cilat kanë mbetur të pa përfunduara nga Komisioni paraparak dhe të njëjtat të sistemohen në zyrat e arkivit dhe të Drejtorive përkatëse .

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë me kopjen e të cilit do të njoftohen Drejtoresha e Drejtoratit për Administratë, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 026/04-22/89
Lipjan, më 15.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në kërkesën e Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të datës 05.05.2026, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR CAKTIMIN E ZYRTARËVE PËRGJEGJËS

I.Me këtë Vendim, caktohen zyrtarët përgjegjës komunalë të cilët do ta ndihmojnë Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari përkitazi me procesin e aplikimit të fermerëve të Komunës së Lipjanit për pagesat direkte në bujqësi, sipas Thirrjes për aplikim për vitin 2026, e cila do të shpallet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ,në përbërje si vijon:

1. Arbëresha Hetemi, Zyra Lokale për Komunitete
2. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Saranda Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa

II. Zyrtarët përgjegjës të cekur më lartë brenda periodës sa zgjat Thirrja publike do të jenë të angazhuar dhe do të punojnë sipas udhëzimeve të Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari përmes sistemit përkatës elektronik.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe zyrtarët përgjegjës të cekur në pikën I të këtij Vendimi.

→ 1Nr. 020/04-20708
Lipjan, 05.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

